



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNALNA SKUPSTINA / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02 - 400/09-004/199/26
D. to 29 04 2026
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, UA përkatëse në fuqi, konform nenit 7 pika 2, nenit 16 pika i) nenit 17, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.01-400/01-0051689/20 të datës 04.12.2020, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, dhe sipas Propozimit të Komisionit të DShMS-së Nr.08-400/01-0008455/26, të datës 04.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** propozimi i komisionit të DShMS-së Nr.08-400/01-0008455/26, i datës 04.03.2026, për subvencionimin e qirasë për katër (4) familje nga Komuna e Skenderajt, të cilat e kanë gjendjen e vështirë ekonomike-sociale, si në vijim:
1. z. [REDAKTUAR], t'i bëhet pagesa e qirasë për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 06.01.2026 deri me 05.07.2026 në shumën prej **170€**, (për muaj) dhe këto mjete të paguhen në emër të Musaj Dobra si qiradhënës;
 2. z. [REDAKTUAR], t'i bëhet pagesa e qirasë për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 28.01.2026 deri me 27.07.2026 në shumën prej **170€**, (për muaj) dhe këto mjete të paguhen në emër të Selam Rukolli si qiradhënës;
 3. z. [REDAKTUAR], t'i bëhet pagesa e qirasë për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 23.02.2026 deri me 22.08.2026, në shumën prej **170€**, (për muaj) dhe këto mjete të paguhen në emër të Musaj Dobra si qiradhënës, si dhe
 4. z. [REDAKTUAR], t'i bëhet pagesa e qirasë për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 04.03.2026 deri me 03.09.2026, në shumën prej **170€**, (për muaj) dhe këto mjete të paguhen në emër të Musaj Dobra si qiradhënës.
- II. Pagesa e mjeteve të lartcekura do të bëhet nga kategoria e subvencioneve të DShMS-së të planifikuara për po të njëjtën çështje.
- III. Obligohet DShMS që në bazë të këtij vendimi të lidhë kontratë me pronaret e banimit, ku përfitues janë personat e lartcekur në pikën I të këtij vendimi, që i kanë plotësuar kriteret sipas Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DSHMS-së
- Palëve

Kryetari i Komunës

Samir Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr.
No. <u>02-020/01-0014673/26</u>
Data.
Data. <u>24. 04. 2026</u>



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 10 të Rregullores Nr.01-463/01-0051690/20, të datës 04.12.2020 Për Dhënie në Shfrytëzim Deri në 1 (një) Vit të Pronës së Paluajtshme, Objekteve, Lokaleve dhe Hapësirave Publike në Komunën e Skenderajt dhe sipas kërkesës së DGJKP-së Nr. 05-020/01-0013829/26, të datës 17.04.2026, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

- I. **FORMOHET** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:
 1. Kreshnik Smakiqi, kryesues
 2. Besart Sadiku, anëtar
 3. Milot Geci, anëtar
- II. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, lidhur me atë se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform Rregullores Nr.01-463/01-0051690/20, të datës 04.12.2020, dhe pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të përgatis raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese.
- III. Mandati i komisionit është dy (2) vite.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen Vendimi Nr.02-020/01-0024078/25, dt. 25.06.2025 dhe Vendimi Nr.02-020/01-0027340/25, dt. 10.07.2025.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

- Arkivit
- DGJKP-së
- Anëtarëve të komisionit

Kryetari i Komunës

Sami Eushaku
Sami Eushaku






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02 020/01-0014261/26
Data 21 04 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, nenit 24, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **Emërohet** Paneli për Strehim Rezidencial në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:
 1. **Albinot Mehmeti**, kryesues;
 2. **Kushtrim Fazliu**, anëtar;
 3. **Ylli Veliqi**, anëtar.

- II. **Detyrë e Panelit** është të bëjë shqyrtimin e kërkesave për dhënien e pëlqimit për vendosjen e të moshuarve pa kujdes familjar në strehim rezidencial sipas kërkesës së Qendrës për Punë Sociale kompetente, vlerësimin e respektimit të procedurave ligjore dhe profesionale nga ana e Qendrës për Punë Sociale, të kërkoj dokumentacion shtesë sipas nevojës, bashkëpunon me mekanizmat e nivelit qendror për strehim rezidencial dhe lokal të një Komune tjetër, si dhe detyrat dhe përgjegjësit të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mandati i anëtarëve të Panelit për Strehim Rezidencial është tre (3) vite.

- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi **shfuqizohet** Vendimi Nr. 02-020/01-0012401/23, i datës 07.04.2026.

- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DShMS-së
- Anëtarëve të Panelit

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku
Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr. No. 02-020/01-00/2347/26
Data. Data. 07. 04. 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, dhe sipas kërkesës së DZHENIT Nr. 12-020/01-0010909/26, të datës 26.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
(Për themelimin e komisionit)

- I. **Themelohet** komisioni për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të aplikuesve në kuadër të projektit “Mbështetje financiare për biznese të vogla dhe start-up”, përmes thirrjes së hapur publike Nr. 12-400/01-0009944/26, në këtë përbërje:
 1. **Mirsad Gashi**, kryesuese;
 2. **Armend Gruda**, anëtar;
 3. **Albina Rushiti**, anëtare.
- II. **Detyrë e komisionit** është të bëjë pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të aplikuesve nga thirrja e hapur publike e cekur në pikën I të këtij vendimi, konform legjislacionit në fuqi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DZHENIT
- Anëtarëve të komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr. No. <u>02-020/01-0012386/26</u>
Data. Data. <u>07.04.2026</u>



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, nenin 23 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe sipas kërkesës së DKRS-së Nr.11-020/01-00010410/26, të datës 24.03.2026, Kryetari i Komunës së Skenderajt merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Ekipi për Monitorimin e Realizimit të Projekt / Programeve nga përfituesit e subvencioneve 2026, për thirrjen publike nr.11-400/01-0003598/26, të datës 23.01.2026 dhe të gjitha thirrjet gjatë vitit 2026, në këtë përbërje:
 1. Albert Lushtaku, kryesues;
 2. Xhevat Dervishi, anëtar;
 3. Shehrije Geci, anëtare;
 4. Bashkim Meha – anëtar (rezervë).
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit të cekur në pikën I janë të përcaktuara në nenin 24 të Rregullores MF Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


I dërgohet:

- Arkivit
- DKRS-së
- Anëtarëve





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Precednika/Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në mbështetje nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, e në zbatim të nenit 6 lidhur me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Fuqionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, sipas nenit 19 të Rregullores Nr.01-110/01-0000794/21 të datës 08.01.2021 për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës, dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Për formimin e ekipit për të drejtat e fëmijës)

- I. **Themelohet** Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, me qëllim të ofrimit të sigurisë që jeta, dinjiteti dhe integriteti i fëmijës të jenë të garantuara dhe të mbrojtura në çdo moment, në këtë përbërje:
 1. **Fadil Nura**, Nënkryetar i Komunës, kryesues i ekipit;
 2. **Hasan Hoti**, Drejtor i DShMS-së, zëvendëskryesues i ekipit;
 3. **Ragip Ymeri**, Zyrtar i DA-së, anëtar;
 4. **Albinot Mehmeti**, Koordinator për Banim Social, anëtar;
 5. **Valbona Hoti**, Zyrtare e DKRS-së, anëtare;
 6. **Leonard Kahrmani**, Zyrtar i DBF-së, anëtar;
 7. **Fikret Rexhepi**, Përfaqësues i KPF-së, anëtar;
 8. **Fatjona Tomasheviq**, Përfaqësuese e KK-së, anëtare;
 9. **Besnik Zabelaj**, Zyrtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, anëtar;
 10. **Agim Idrizi**, Përfaqësues i Policisë, anëtar;
 11. **Shyhrete Hetemi**, Përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale, anëtare;
 12. **Milazim Mustafa**, Përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar.
- II. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe këshilltarëve të jashtëm janë:
 1. **Diona Haziraj**, Përfaqësuese e Fëmijëve, anëtare;
 2. **Avdi Jakupi**, Kryetar i Këshillit të Prindërve, anëtar;
 3. _____, Përfaqësues i Avokatit të Popullit, anëtar;
 4. **Shkendiza Kllokoqi-Doroci**, Përfaqësuese e Organizatës Ndërkombëtare OSBE, anëtare;
 5. **Hana Zabeli**, Përfaqësuese e Organizatave Vendore, anëtare
- III. **Z. Besnik Zabelaj** caktohet si sekretariat për të koordinuar, monitoruar dhe zhvilluar aktivitetet e nevojshme për punën e ekipit.
- IV. Detyrat dhe përgjegjësit e ekipit për të drejtat e fëmijës janë të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në Udhëzimin (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Fuqionalizimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi **shfuqizohet** Vendimi Nr. 02-020/01-0026497/23, i datës 25.05.2022, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 02-020/01-0023343/24, të datës 17.05.2024.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:


- Arkivit
- Anëtarëve të ekipit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 02-370/09-0095126/26
Data 27 04 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DUMA-së Nr.06-351/01-0010036/26, të datës 19.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


(Mbi lejimin e zhvillimit të procedurës)

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të tenderimit për aneks projektin: “Riparimi dhe rregullimi i parkut “Idriz Rreci” dhe “Shaban Polluzha”, Komuna e Skenderajt”.
- II. **Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit për aneks projektin sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së

Kryetari i Komunës


Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSAMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No.
Data
Date

02-370/09-0015/15/26
27 04 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DUMA-së Nr.06-351/01-0010035/26, të datës 19.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Mbi lejimin e zhvillimit të procedurës)

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të tenderimit për aneks projektin: “Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha, Komuna e Skenderajt”.
- II. **Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit për aneks projektin sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së

Kryetari i Komunës


Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KRYETARI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-370/04-0015264/26
No. 28 04 2026
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DShMS-së Nr.08-370/01-0009256/26, të datës 12.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


(Mbi lejimin e zhvillimit të procedurës)

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të tenderimit për projektin: “Furnizim me medikamente shëndetësore (barna) për ShPMPF - Skenderaj”.
- II. **Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit për projektin sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DShMS-së
- DPP-së

Kryetari i Komunës


Sami Lusitaku






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SHUPËSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-370/01-00/15168/26
Data.
Data. 28. 04. 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DUMA-së Nr.06-370/01-0011460/26, të datës 30.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

(Mbi lejimin e zhvillimit të procedurës)

- I. Me këtë vendim lejohet zhvillimi i procedurave të tenderimit për **Hartimin e Projekteve Teknike**.
- II. **Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku
Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SKENDERAJ / MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

Nr. 02-111/01-0014205/26
Pr. 21.04.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sipas kërkesës së NjMBNj-së Nr. 02-111/01-0013871/26, të datës 17.04.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të konkursit për plotësimin e pozitës:
 - Zyrtar për Komunitete – një (1) pozitë
- II. **Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore** të bëjë zhvillimin e procedurave nga pika I, konform legjislacionit në fuqi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- NjMBNj-së

Kryetari i Komunës


Samir Lushitaku





REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNALASAVETI OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-111/01-0015303/26
Data	
Data	28.04.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sipas kërkesës së DShP-së nr.09-111/01-0014657/26, të dt. 24.04.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të konkursit për plotësimin e pozitës:
 - **Zyrtar për Emergjencë – një (1) pozitë**
- II. **Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore** të bëjë zhvillimin e procedurave nga pika I, konform legjislacionit në fuqi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- NJMBNJ-së

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku
Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-351/01-0013466/26
Data.
Data. 15-04-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas Kërkesës së DUMA-së Nr.06-351/01-0008862/26, të datës 09.03.2026, bazuar në Raportin nr.06-052/01-002490/26, të datës 07.04.2026, të hartuar nga komisioni i emëruar me Vendimin Nr.02-020/01-0010861/26, të datës 26.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohen punët për riformatim të projektit “Ndërtimi i Urave në fshatin Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Terrnavc, Tushilë dhe Kilodernicë” - Komuna Skenderaj.**
- II. Projekti sipas pikës I të këtij vendimi është zhvilluar me Kontratën Nr.03-370/01-0020477/26, të datës 26.09.2026, ku kryes i punimeve është: “MIRUSHA COMPANY” SH.P.K - Klinë, andaj duke u bazuar në vlerësimin e komisionit sipas Raportit nr.06-052/01-002490/26, të datës 07.04.2026, është paraqitur nevoja për riformatim të paramasës, për tu përfunduar dhe funksionalizuar projekti në tërësi.
- III. **Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, që në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit Publik të bëjnë zbatimin e këtij vendimi, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur: Raporti i Komisionit nr.06-052/01-002490/26, i datës 07.04.2026, Paramasa dhe Parallogaria.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së

Kryetari i Komunës

Sami Mushiaku
Sami Mushiaku

